L I G J
Nr.9524, datë 25.4.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8537, DATË 18.10.1999
"PËR BARRËT SIGURUESE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

1. Paragrafi i dytë i nenit 25 ndryshohet si më poshtë:
"Regjistri i Barrëve Siguruese është zyrë, që vepron në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.".
2. Paragrafi i tretë i nenit 25 shfuqizohet.

Neni 2

Paragrafi i parë i nenit 26 ndryshohet si më poshtë:
"Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nxjerr dhe miraton rregulloren e barrëve siguruese për:".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4866, datë 10.5.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu